



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më **18.3.2024**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përvendoset përfundimtje për të gjithë! Përvendoset përfundimtje nënkyetar **Fatmir Iska!** Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtore të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, të gjithë ju të pranishëm! Faleminderit shumë për pjesëmarjen! E hapim mbledhjen e tretë (3) të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim me kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë rend dite:

R E N D D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenuara nga viti 2022 dhe 2023, në vitin 2024;**
- 3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarjen e P-02658-0, ZK-Rahovec dhe formimi i parcelës së re në emër të Komunës së Rahovecit;**
- 4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër nga 1-15 vjet për organizatat e shoqërisë civile, P-00301-3, ZK-Bërnjak;**
- 5. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00301-3, ZK-Bërnjak;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryesuesi: A kemi ndonjë pikë shtesë apo propozim nga anëtarët e KPF-së?...

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkyetar, kolegë të KPF-së. Në mbledhjen e kaluar të KPF-së e kam bërë një propozim për ndryshimin e emërtimit të pikës së dytë të rendit të ditës të seancave të rregullta, por që siç e keni parë, nuk është marrë ndonjë veprim drejt atij propozimi. Propozoj që të vendoset në votim këtu në KPF.

Kryesuesi: Atëherë, asambleisti Kafexhiu propozon që të plotësohet dhe të ndryshohet pika e dytë e rendit të ditës të mbledhjes së Kuvendit.

Burim Krasniqi: Pika e dytë ka të bëjë për bartjen e mjeteve vetanake, për këtë apo për Kuvend?

Kryesuesi: Është fjala për Kuvend, "Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve".

Shqipe Kryeziu: Faleminderit, kryesues! Përvendoset përfundimtje për të gjithë! Pika e dytë të emërohet ndryshe, apo si?... Apo të kalojë si pikë e fundit? Mirë do të ishte që të kalohet si pikë e fundit e rendit të ditës. Propozoj që të kalojë si pikë e fundit.

Defrim Kafexhiu: Atëherë, unë e kam bërë propozimin për ndryshimin e pikës së dytë të rendit të ditës dhe të emërohet, si: "pyetje, përgjigje dhe diskutime", ose me ndonjë emërtim që ju si ekzekutiv, në konsultim me

kryetarin, e shihni të arsyeshëm, të vazhdojë të qëndrojë e dyta, por që nuk diskutohet e drejta e cenimit të fjalës për anëtarët e Kuvendit.

Shqipe Kryeziu: Ne si Aleancë, propozjmë që kjo pikë të bartet në fund dhe të jetë si pikë e fundit e rendit të ditës.

Skender Hamza: Përshëndetje, kryesues, kryetar, kolegë! Para kësaj mbledhjeje të KPF-së, rendin e ditës për kuvend e keni pasur me rekomandime të dala nga KPF-ja. Aty ka qenë edhe propozimi i Defrimit, që kjo pikë e rendit të ditës të plotësohet dhe të ndryshohet. Në mbledhje, askush s'e ka kërkuar fjalën për ndryshimin e kësaj pike. Gjithmonë, kjo pikë, me emërtim ka qenë “Të ndryshme”, ku janë bërë diskutime sipas rregullores së Kuvendit. Plotësim-ndryshimi i pikës dhe renditja e saj, u takon anëtarëve të Kuvendit, me votë.

Burim Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket renditjes, ne jemi dëshmitarë që shpeshherë nuk kemi kuorum në pikë të rregullta, e lëre më në diskutime. Tendenca për ta shtyrë në fund, është tendencë që të bëhet “hajgare” me këtë pikë të rendit të ditës. “Të ndryshme” është praktikë e fundit, ku në rast nevoje shtohet diçka. Riemërimi “...dhe diskutime” është i logjikshëm, sepse edhe ashtu, ndonjëherë dalim nga pyetjet dhe përgjigjet. Në KPF-në e fundit, nuk kam qenë, por propozimi i Defrimit, nëse është planifikuar të vendoset në rend dite në seancën e rregullt, atëherë është dashur të vendoset në kuvend për votim. Nëse ka vullnet të shtyhet tutje propozimi i Defrimit, ne e vendosim në KPF, kalon, shkon si propozim prej KPF-së dhe Asambleja a e pranon ose jo, përsëri vendoset në Asamble në rend dite.

Shqipe Kryeziu: Për plotësim-ndyshim të pyetjeve dhe të përgjigjeve ne nuk pranojmë. Kërkesa ime është që të kalojë si pikë e fundit.

Defrim Kafexhiu: Ka qenë si rekomandim i bashkëngjitur me ftesën për mbledhjen e kuvendit, por kryesuesi nuk i ka lexuar propozimet e KPF-së, në fillim të seancës. Burim, propozimin nuk e kam bërë për ta vendosur në votim, por e kam bërë një propozim që me vullnet të kryesuesit dhe të kryetarit, që ata të vendosin për ndryshimin e pikës. Meqenëse nuk ka ndodhur, sot e propozoj që me votë të vendoset në Kuvend. Propozimi i Shqipes është jo i drejtë, joparimor dhe tendencioz, sepse nëse kjo pikë synohet të vendoset në fund të rendit të ditës, mendoj që cenohet e drejta e diskutimit dhe e drejta e përfaqësimit të anëtarëve të Kuvendit Komunal në Rahovec.

Burim Krasniqi: Unë e di që momentalist Aleanca e ka përkrahjen me shumicë votash ta kalojë edhe të fundit, të dytën e të tretën. Pa dashur të keqkuptohem, kalimi në pikën e fundit është qëllim i ngufatjes së zërit në Asamble Komunale. Nëse kjo çështje votohet, unë paralajmëroj këtu që LDK nuk merr pjesë në seancat e Asamblesë Komunale, “Ju mundeni, ju dini, ju grahni”.

Shqipe Kryeziu: Burim, bëhet fjalë për diskutime. Përderisa shtohet një pikë e re e rendit të ditës për diskutime, mendoj që nuk kemi nevojë, sepse është e formuluar mirë.

Nënkyetari: Faleminderit! I nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë, përfaqësues të KFOR-it, të pranishëm. Të rikthehem i pak në retrospektivë: Kam qenë edhe unë i ulur aty, ku sot jeni ju. Burimi ka qenë gjithashtu një kohë dhe më kujtohet kur e kishim si pikë të rendit të ditës “Të ndryshme”, sepse pika “Pyetje-përgjigje” nuk ka ekzistuar. Në renditje, e dyta apo e fundit do të vendosë edhe në këtë rast Kuvendi i Komunës. Nëse shkojmë, në thonjëza, me “kërcënime” për mospjesëmarrje të një grupei politik për shkak që ekziston një votë e caktuar, për ta vendosur një çështje të caktuar, atëherë është e drejtë e secilit të vendosë. Të cenohet e drejta e shumicës së kuvendit, në këtë rast e Aleancës, që t'ia kufizosh të drejtën me votë, a dëshiron të votojë apo jo. Unë nuk besoj që kjo pikë e rendit të ditës duhet të jetë në këtë format që ju e keni parashtruar. Kur ju ishit në pushtet, atëherë me PDK-në bashkë në qeverisje, e dyta ka qenë pika e rendit të ditës “të ndryshme”, pastaj e keni bartur si të fundit dhe përsëri ping-pong është bartur si pikë e dytë e rendit të ditës. Të jemi të qartë, secili vendim që merret në seancë është në dorë të kuvendarëve.

Burim Krasniqi: Nënkyetar, nuk e di a jemi duke i kapur drejt veprimet politike secili nga ne. Dikur Aleanca me Vetëvendosjen edhe gaz lotsjellës kanë hedhur në Kuvend të Kosovës për t'i mbrojtur kauzat e veta, e ti thua që

është kërcënëm. Nuk është kërcënëm, është qasje e jona. Po më vije keq që po them kështu, megjithatë, ashtu siç është vullneti i një shumice të caktuar të veprojë ashtu siç do për vete, njëjtë është edhe për një pakicë të vlerësojë siç do për vete. Tek e fundit, faturën politike e paguan çdo kush të veten. Mos të keqpërdoret një shumicë për ta ngulfatur diskutimin në Asamble Komunale. Kjo shumicë, nuk po arrin t'i menaxhojë asambleistët e vet. Kurrë kuorum nuk ka prej asambleistëve që i takojnë shumicës. Kur nuk ka kuorum për pikë në fillim, paramendoje çka do të ndodhë te “të ndryshme” dhe për këtë gjë është tendencë për të bërë “hajgare”.

Nënkyetari: Burim, këto që i përmende janë të pakrahasueshme. Nëse subjektet politike kanë gjuajtur gaz lotsjellës, e kanë bërë për një kauzë dhe ndoshta edhe unë kam qenë pjesë e përkrahjes së tyre në atë kohë, bashkë me kolegët që i kemi të Vetëvendosjes. Sa i përket pikës së rendit të ditës, nuk jemi për ta hequr komplet, duhet të jetë aty, si dhe te renditja, vendoset me votë nga secili. Nuk kam çfarë të bëj që Aleanca i ka 15 numra, fitoni edhe ju. Vota është përcaktuese dhe ajo determinon saktë se kush dhe cilin vend e ka.

Skender Hamza: E mbaj në mend shumë mirë, se pse kjo pikë ka kaluar e dyta në renditje. Ka qenë kërkesë nga asambleistët për shkak se drejtorët e drejtorive nuk kanë qëndruar deri në fund të seancës për t'u përgjigjur në pyetje që do t'u parashtruheshin. Përndryshe, kjo pikë gjithmonë ka qenë e fundit.

Kryesuesi: Atëherë, asambleisti Defrim Kafexhiu ka bërë propozim për ndryshim të emërtimit të pikës së dytë. Propozimi të dërgohet në kuvend. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 5 vota “për” dhe 2 kundër kalon propozimi.

Shqipe Kryeziu: Nuk e kam të qartë, propozimin që unë e bëra, kalon direkt në kuvend dhe aty votohet ose jo?...

Kryesuesi: Po, ashtu është.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Atëherë, a ka dikush diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet procesverbalı.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 dhe 2023, në vitin 2024;

Afrim Limani: I nderuar kryesues, nënkyetar, anëtarë të KPF-së! Duke u bazuar në Ligjin e Buxhetit 2024, nen 9, pikë 7, ne si Komunë e kemi përgatitur një dokument për bartjen e mjeteve nga viti 2022 dhe 2023, në vitin 2024. Shuma e vlerës në total është 654.100€. 630.000 janë të hyra vetanake dhe pjesa tjeter janë mjete të mbetur nga fondi burimor 2022. Kemi tentuar t'i mbulojmë disa kontrata që nuk kanë qenë të buxhetuara, kemi projekte të reja për 2024, si dhe pjesa e mbetur do të jetë mbulimi i projekteve ekzistuese. Të nderuar anëtarë të KPF-së, kërkoj nga ju që të votohet kjo pikë e rendit të ditës.

Leonard Morina: Faleminderit, kryesues! Pëershëndetje për nënkyetarin, drejtorët dhe të gjithë të pranishmit! Më duket që në disa seanca keni thënë që bartja e mjeteve nuk lejohet në projekte të reja, këtu po i shoh disa projekte të reja.

Burim Krasniqi: Faleminderit! Drejtor, bartja e mjeteve është obligim moral dhe ligjor i seçilit asambleist, sepse nuk ka logikë që mjetet e komunës të mbesin të ngrira për shkak të tekeve politike. Kërkoj që në seancën e rregullt është mirë ta kemi një shpjegues se ku janë propozuar mjetet më saktë, që secili asambleist ta gjejë veten.

Afrim Limani: Leonard, faleminderit për pyetjen! Sipas ligjit të financave publike dhe përgjegjësive, lejohet bartja e mjeteve në këtë periudhë. Gjithashtu lejohet edhe krijimi i projekteve të reja me ligj të buxhetit të vitit 2024. Nëse ju kujtohet, në shtator, kur e kemi votuar buxhetin, kam deklaruar se i vetmi projekt që nuk po mund të buxhetohet është rrëthimi i oborrit të shkollës dhe e kam lënë që këtë projekt do ta vendosim me bartjen e mjeteve të vitit 2023.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Nëse nuk keni edhe ndonjë gjë tjeter, këtë pikë e kalojmë në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Atëherë, me shumicë votash, votohet edhe pikë e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarjen e P-02658-0, ZK-Rahovec dhe formimi i parcelës së re në emër të Komunës së Rahovecit:

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkyetar, kolegë, anëtarë të KPF-së. Para jush keni propozimin e kryetarit të Komunës, për një parcelë komunale, që gjendet saktësisht te rruga tranzite. Qëllimi i këtij propozimi është se përreth kësaj parcele ka prona private që nuk kanë dalje në tranzit. Ne dëshirojmë ta ndajmë këtë parcelë, ta krijojmë edhe një parcelë tjetër me numër dhe sipërfaqe të re, me pronar të njëjtë. Në të ardhmen, pronarët e atyre parcelave private ta shfrytëzojnë si të drejtë kalimi për të dalë në rrugën tranzite. Pra, parcella me nr. 2658-0, në sipërfaqe prej 2 ha 97 ari e 2m² dhe të formohet një parcelë e re prej 7ari e 75m².

Defrim Kafexhiu: Drejtor, the që parcella nuk ka dalje në rrugën tranzite. Atëherë, këto 7 ari prej kujt do të shfrytëzohen dhe në çfarë forme?

Burim Krasniqi: Drejtor, parcella 2658-0 është pronë komunale. Prej kësaj po kërkohet që të ndahet një sipërfaqe prej 7.75 ari për t'i krijuar qasje parcelave që janë përreth. Parcella 2651-1 është pronë private apo pronë komunale? Dua të flas në parim. Ne i kemi edhe parcelat 2660-1, 2660-2, 2660-3 etj... që e kanë të njëjtën pamundësi për qasje në rrugën tranzite për shkak të parcelës komunale. Konsideroj që nëse dëshirojmë të veprojmë në parim për të krijuar mundësinë, është mirë që për këtë parcelë ta shikojmë mundësinë të krijojmë qasje për të gjitha parcelave përreth dhe paralelisht. Të jetë një vendim në parim prej Asamblesë Komunale dhe një propozim prej ekzekutivit që t'u krijojmë qasje të gjithë qytetarëve aty rrëth parcelave të veta.

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! Në pyetjen e kuvendarit Defrim Kafexhiu: Parcellën që e ndajmë është e Komunës dhe kjo parcelë ka dalje në rrugë tranzite, mirëpo, parcelat private përreth kësaj parcele, nuk kanë dalje. Me këtë ndarje, në të ardhmen, do të lejojmë që këto parcella që kufizohen me këtë parcelë të kenë dalje në tranzit. Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi, është që këto parcella në anën e majtë kanë dalje në rrugë kryesore Rahovec-Malishevë dhe pronarët e këtyre parcelave kanë qasje në tranzit. Qëllimi se pse në këtë vendim nuk po i përmendim numrat e parcelave private, është se në të ardhmen, këto parcella mund të ndahen dhe t'i kenë numrat e rinj.

Burim Krasniqi: Drejtor, nuk kërkova të përmendim numra. I mora shembull numrat që t'i shohim në skicë, asgjë tjetër. Parcelat 2660-1, 2660-2, 2660-3 nuk kanë qasje as në tranzit, as poshtë në qytet. Nëse janë të të njëjtë pronar edhe parcelat mbi, edhe parcelat përfundi, është muhabet tjetër. Por, këto parcella këtu nuk po e shoh që kanë qasje qoftë në rrugën e qytetit (Lagjja e Epërme), qoftë te pjesa e tranzitit lart.

Afrim Oruqi: Këto parcella, që me të drejtë po i përmend kuvendari Burim, janë të të njëjtëve pronarë me mbiemër Shala. Këta nuk e kanë atë problem, kanë dalje, por nuk ka rrugë në kadastër dhe gjeoportal, nuk paraqitet rruga.

Kryesuesi: Atëherë, nëse nuk kemi diskutime të tjera, këtë pikë e kalojmë në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me shumicë votash votohet pika e tretë.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër nga 1-15 vjet për organizatat e shoqërisë civile, P-00301-3, ZK-Bërnjak:

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! Duke u bazuar në ligjet e Republikës së Kosovës, kryetari i Komunës ju propozon që ta japim në shfrytëzim deri në 15 vjet parcellën me nr. 00301-3, në sipërfaqe 4.86 ari, e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 15 ari, duke përfshirë edhe objektin e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë. Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Bërnjak (shtëpia e verës) dhe qëllimi i dhënies në shfrytëzim është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim është i cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi dhe është për periudhën 5-vjeçare, me çmim 350€ për muaj.

Burim Krasniqi: Faleminderit, kryesues! Shtëpia e verës është njëra prej destinacioneve që e ka ruajtur Komuna në një formë ku është bërë ekspositura e produkteve të verës dhe ka qenë pikë destinimi për vizitorë, kur janë organizuar ngjarje të ndryshme dhe ndër to edhe Festa e Vjeljes së Rrushit "Hardh Fest". Konsideroj që nuk është

mirë që këtë objekt ta japim në shfrytëzim, më mirë është ta mbajë Komuna. Nëse nuk ka rregullore, ta nxjerrim një rregullore. Komuna t'u japë në shfrytëzim OJQ-ve në raste të caktuara me, një kosto të caktuar dhe të jetë e menaxhueshme prej komunës. Mendoj që objekti duhet ta ruajë destinimin që e ka. Në momentin që e merr një OJQ, ajo do të jetë komplet menaxhuese. Menaxhimi është llaf tjetër, shfrytëzimi llaf tjetër.

Afrim Oruqi: Këtë shtëpi e kemi kompletuar edhe me elementet e tjera përcjellëse. Dëshirojmë ta funksionalizojmë dhe qëllimin do ta caktojë komisioni. Për momentin është pronë komunale në menaxhim të Drejtorisë së Ekonomisë.

Defrim Kafexhiu: E kam edhe një pyetje për drejtorin: A ka pasur kërkësë prej OJQ-ve për veprimtaritë e tyre, apo ka qenë iniciativë e juaja që ky objekt dhe kjo parcelë të jepet në shfrytëzim. Gjithashtu, mendoj që është e paarsyeshme dhënia në shfrytëzim, për shkak të investimeve që Komuna e Rahovecit i ka bërë në atë objekt, së fundi është bërë edhe në vitin 2023, renovimi i shtëpisë së verës. Duke e dhënë në menaxhim, ju po tregoni paaftësi në menaxhim. Por edhe nëse OJQ-të kanë nevojë për hapësira të tilla, mendoj që me një rregullore përcaktohet ofrimi i hapësirës për shfrytëzim, por të jetë pronë e Komunës dhe jo të jepet për 15 vjet.

Afrim Oruqi: Ju informoj që, përveç kësaj pike, ne jemi duke përgatitur material që në seancat e radhës t'i japim në shfrytëzim edhe kompleksin në Gradish dhe Majën e Shkodranit, në mënyrë që të mirëmbahen dhe të ruhen. Kjo pronë po propozohet që të jepet në shfrytëzim për 5 vjet dhe jo për 15 vjet. Deri sot, asnjë kërkësë prej OJQ-ve nuk ka. Lutemi që të ketë, sepse qëllimi ynë është që ta funksionalizojmë shtëpinë e verës. Këta që e marrin në menaxhim është normale që duhet të hapin diçka aty, sepse kjo ka kosto. Komisioni do t'i caktojë kriteret dhe qëllimin.

Burim Krasniqi: Drejtor, më tërhoqet që flas edhe një herë. "Shtëpia e Verës" me "Kompleksin në Gradish" dhe "Majën e Shkodranit" dallojnë komplekt. Kompleksi në Gradish është shumë mirë të ketë përkujdesje, sepse fatkeqësisht është destinacion i punëve të këqija. Ka grumbullime të të rinxve dhe keqpërdoret kompleksi rrëth hapësirës jashtë dhe brenda saj. Ka qenë një projekt që prej fillimit është zhvilluar pa konsultim fillimisht me familjet e dëshmorëve, sepse ka ende varreza që kanë mbetur hapur dhe nëse e japim në shfrytëzim, si do të bëhet kjo? A paguar dikush qira për vizitë aty brenda? Sa vizitorë deri sot i ka pasur kompleksi? Prapë duhet t'ia jepni dikujt dhe ta financoni vetë, sepse nuk ka mundësi tjetër. Thjesht janë dy gjëra të ndryshme, te "Shtëpia e Verës", jam i bindur që do të ketë kërkesa të njerëzve për ta marrë në ngjarje të caktuara.

Afrim Oruqi: Qëllimi pse i përmenda këto dy pika, doja t'ju tha që po hyjmë në një faze të re, që jemi duke u munduar që, përveç investimeve edhe t'i funksionalizojmë.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Nëse nuk kemi diskutime të tjera lidhur me këtë pikë, e kalojmë në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 4 vota "për" dhe 1 kundër kalon pika e 4.

5. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00301-3, ZK-Bërnjak;

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! Bazuar në ligjet e aplikueshme, kryetari i Komunës ju propozon që të formoni një komision për zbatimin dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Bëhet fjalë për parcelën e njëjtë 00301-3, ZK-Bërnjak. Komisioni, sipas pikës 1, duhet të ketë përbërje prej 5 anëtarëve, 2 përfaqësues nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile.

Burim Krasniqi: Dua të them që nuk e votoj "për", sepse në parim nuk po pajtohem që parcella të jepet në shfrytëzim dhe njëjtë nuk mund të pajtohem që të ketë një komision.

Kryesuesi: Faleminderit! Nëse nuk kemi diskutime të tjera lidhur me këtë pikë, e kalojmë në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 5 vota "për" dhe 1 kundër dhe 1 abstenim, kalon pika e pestë.

6. Të ndryshme:

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! Meqenëse drejtori i Arsimit nuk është këtu, po e pyes nënkyretarin. Kur do të fillojë procesi i ndarjes së bursave për vitin 2024. Bursa për studentë dhe për nxënës të shkollave të mesme.

Një pyetje për drejtorin e Gjeodezisë dhe Kadastrës si menaxher i projektit për meremetimin e varrezave të martirëve: Ka qenë 16 janar një reagim që e ka bërë faqja e Komunës së Rahovecit në emrin tënd: “Për një deklaratë të shëmtuar të anëtarit të kuvendit”, e keni pasur fjalën përmua. Ke thënë që është në proces dhe më pate thënë që bashkë me një veturë do të shkojmë që t'i shohim punët atje. Kanë kaluar dy muaj dhe ende nuk ka asnjë veprim nga ju si menaxher i projektit dhe dua të të pyes se kur do të fillojë procesi i rregullimit të varrezave të martirëve?

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! Singersht në lidhje me reagimin tim, ka qenë gjysma e reagimit tim, sepse nëse do të ishte njëmend i imi, atëherë kishte me qenë në proporcion me reagimin tênd. Unë jam shumë i kujdeshshëm në këtë gjë. Jam shumë i nderuar që e menaxhoj atë kontratë, sepse ka të bëjë me njerëzit më të pafajshëm në këtë tokë pas luftës. Ata padrejtësish janë privuar nga jeta, duke u kapur nëpër shtëpi, rrugë dhe nëpër lagje. Ka qenë reagim i imi, por jo në proporcion me reagimin tênd. Javë e kaluar e kemi nënshkruar një kontratë, më të madhen pas luftës (mbi 200.000€) për meremetim të varrezave të dëshmorëve, të civilëve, të martirëve. Kemi filluar të punojmë në Opterushë, jemi duke punuar në Rahovec, në Brestoc, do të kalojmë në Pastasel dhe pas Pastaselit vlen e njëjta thirrje që, bashkë unë edhe ti, me një veturë, do të fillojë të punojmë te varrezat e martirëve (69 martirë) dhe shpresojmë që do t'i identifikojmë, sepse ka prej tyre që janë pa emra, pa datë të lindjes e të vdekjes.

Burim Krasniqi: E pata një pyetje për Drejtorinë e Financave. Fillimi, kérkoj mirëkuptim nga ekzekutivi që kur të bëhen pyetjet prej asambleistëve, ndoshta duken paksa të ashpra, por të jeni më të butë dhe më të kursyer në përgjigje. Nëse thuhet që janë në gjendje të mjerueshme dhe nuk dihet emri dhe mbiemri, më vjen keq, por 2009-2013 ka qenë ky ekzekutiv, 2017-2021 dhe 2021-2024 dhe së paku emrat dhe mbiemrat është dashur t'i gjeni prej fillimit dhe jo t'i lini deri më sot. Duhet secili nga ne ta marrim seriozisht këtë temë. Drejtor, nuk të kérkoj sot përgjigje, por meqenëse në seancën e fundit e kam bërë pyetjen rreth procedurave përbërimore, kam një informatë jozyrtare që para 2-3 dite përbërueshi i ka marrë rreth 500.000€ për zbatimin e kontratës kolektive. Të lutem që të përfshihen ngjarjet e ndodhura në pyetjen time për Asamble Komunale.

Nënkyetari: Te pyetja e asambleistit Defrim Kafexhiu për bursat. E kemi diskutuar dhe nuk mund të them përmomentin që shumë shpejt do të hapet konkursi për aplikim, po ju garantojmë që brenda këtij viti ose në periudhën e dytë 6 – mujore do të hapet konkursi për aplikim për bursa dhe do të janë mbi 170.

Afrim Limani: Në fillim të vitit 2024, ka ardhur një lëndë përbërimore që është ekzekutuar, kryesisht me kontrata kolektive me vlerë 220.000€. Para dy-tri dite që the ti që ka ardhur edhe një. Aty ka gabime dhe ka përsëritje dhe që 80 mijë € janë të përsëritura. E mira e kësaj pune është që këto mjete tërhiqen vetëm nga kategoria e pagave dhe në fund të vitit në tre muajt e fundit, ligji lejon që aty ku ka para të lira mund të tërhiqen. Kështu që, në tetor ne do ta shpenzojmë buxhetin.

Burim Krasniqi: Në qoftë se merren prej pagave dhe mëditjeve dhe nuk ka vullnet prej qeverisë të kompensohen pagat dhe mëditjet, çka ndodh?

Afrim Limani: Shembull të njëjtë kemi pasur edhe në dhjetor të vitit të kaluar 2023. Kjo ka ndodhur për shkak të ndryshimit të ligjit të pagave dhe ka pasur deficit buxhetor, si dhe në fund Ministria e Financave e ka mbuluar pozicionin e pagave në vlerë prej 1.4 milion€. Sipas ligjit, qeveria detyrohet të mbulojë planifikimin e buxhetit në kategorinë e pagave. Shpresojmë që sivjet të krijohet kontrata kolektive (pagesat, shujtat, shpenzimet e udhëtimit).

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Ju informoj që në mbledhjen e rregullt të kuvendit, si pikat të rendit të ditës do të janë edhe këto:

1. Vendim për subvencionimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2024;
2. Vendim për dhënen në shfrytëzim të repartit të hemodializës ShSKUK-së;
3. Informatë rreth menaxhimit të aseteve komunale;
4. Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre;
5. Informatë rreth Planit për Banim Social;
6. Raporti i Komitetit të Auditimit të Brendshëm;
7. Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit të qytetit në Rahovec.

Burim Krasniqi: Kryesues, ju lutem me mirëkuptim! Pikit shtesë të rendit të ditës është mirë të jenë në KPF, t'i kalojmë ne këtu dhe t'i bëjmë gati për kuvend. Çdo vendim që është në parim dhe në rregull, nuk kemi nevojë të bëjmë politikë, kjo është demokracia.

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi



Arbër Zenuni